



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.122/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Shukri Sylejmani, kryesues, Muhamet Rexha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, përkritazi me ankesën e Blerta Maliqaj kandidatë për deputetë nga rradhet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër QNR-së në lidhje me parregullsi të procesit të rinumerimit votave, në seancën e mbajtur më 02.02.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Blerta Maliqaj kandidatë për deputetë nga rradhet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

ARSYETIMI

Më datë 31.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga Blerta Maliqaj kandidatë për deputetë nga rradhet e subjektit politik PDK, në të cilën pretendohet se “*me rastin e rinumerimit të 40 % të fletvotimeve, në këtë proces nga totali i 1932 votave që kandidatja ka fituar në komunën e Klinës përkatësisht ka fituar 1802 vota sipas KKZ-së në Klinë*”. Parashtruesja e ankesës pretendon se pas manipulimit në QNR ajo ka vetëm 1538 vota në Klinë. Parashtruesja e ankesës kërkon nga PZAP-i që të urdhërohet rinumerimi i mirëfillitë i votave të Klinës.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se pretendimet e parashtrueses së ankesës janë të pabazuara per shkak se nuk eshte bashkangjirur asnjë provë materiale si dëshmi që do ta bënte të besueshme ekzistencen e shkeljes së pretenduar, si dhe në asnjë moment parashtruesja nuk ka arritur të mbeshtes me argumenta dhe fakte shkeljen e pretenduar. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 122/2011 më datën 02.02.2011.

